

## Komiteti Teknik në Suedi

Këtë vit, nga data 6 - 8 shtator u organizua mbledhja e rradhës e EURAMET në Borås të Suedisë. Pjesëmarrës ishin shumë shtete të Europës. Në këtë komitet Teknik u prezantuan projekte të cilat janë implementuar dhe projekte të cilat janë në implementim e sipër. Gjatë takimeve u propozuan ide të reja për realizimin e projekteve në dobi të metrologjisë europiane. Përpos takimeve, qendra RISE në Suedi kishte organizuar edhe vizitë në laboratorët e tyre, me ç'rast pjesëmarrësit patën mundësinë të shohin nga afër mënyrën si funksionon laboratori i presionit, masës, etj..

Poashtu u bë dhe prezantimi i projektit për kalibrimin e instrumenteve për matjen e shtypjes së gjakut në sy në të cilin janë pjesë aktive shtetet si Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Çekia dhe Moldavia. Koordinator i këtij projekti është Instituti i Metrologjisë në Çeki.

Stafi i Byrosë për Metrologji nga Maqedonia e Veriut ishte e përfaqësuar nga pesë të punësuar në sektore të ndryshme të po këtij institucioni të cilët kishin mundësinë të krijojnë kontakte të reja dhe mundësi të tjera për bashkëpunim.

